

Në bazë të nenit 42, paragrafi 1, alineja 1 dhe 5, nenit 47, paragrafi 2, alineja 1 dhe 5, nenit 52, paragrafi 2, alineja 1 dhe 5, nenit 90, paragrafi 1, alineja 1, 2 dhe 3 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.178/2021) dhe nenit 34 të Statutit të Konferencës interuniversitare nr. 19-1010/2 të datës 6.11.2018 dhe nr.19-1245/3 të datës 23.12.2021, Konferenca interuniversitare e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon:

THIRRJE PUBLIKE nr. 2/2024

për zgjedhje të anëtarëve nga Konferenca interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në:

1. Bordin për vlerësim të arsimit të lartë

- **1 (një) person nga rendi i profesorëve**, në marrëdhënie pune në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, nga fusha hulumtuese-shkencore të nivelit të parë sipas Klasifikimit ndërkombëtar fraksativ: *Shkencat bujqësore dhe veterinare*;
- **1 (një) person nga rendi i profesorëve**, në marrëdhënie pune në Universitetin "Goce Dellçev" në Shtip, nga fusha hulumtuese-shkencore të nivelit të parë sipas Klasifikimit ndërkombëtar fraksativ: *Shkencat mjekësore dhe të shëndetësisë*.
Kushtet për zgjedhje:
 - të kenë të publikuar së paku 10 punime shkencore në publikim shkencor referimi, përveç profesorët për lëndë profesionale të artit;
 - nuk janë të zgjedhur për rektor, prorektor ose kryetar i senatit të universitetit, dekan ose prodekan të fakultetit, gjegjësisht drejtor të shkollës së mesme profesionale, drejtor i institutit shkencor i cili realizon veprimtari të lartë arsimore, anëtar i Këshillit nacional ose anëtar i Bordit për akreditim.
- **1 (një) person nga rendi i studentëve** të universiteteve anëtare të Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Kushtet për zgjedhje:
 - të jetë student i rregullt në Universitetin Evropian në Shkup.

2. Bordin për akreditim të arsimit të lartë

- **1 (një) person nga rendi i studentëve** të universiteteve anëtare të Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Kushtet për zgjedhje:
 - të jetë student i rregullt në Universitetin "Nëna Terezë" në Shkup.

Kandidatët parashtrajnë:

- fletëparaqitje sipas shpalljes;
- biografi të shkurtë (CV);
- formular të plotësuar për të dhëna (në dispozicion në ueb faqen e UKIM <http://www.ukim.edu.mk/> në linkun „Dokumente-IKRSM“).

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në seancën e Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Statutin e Konferencës interuniversitare.

Thirrja publike zgjat **8 ditë pune**, llogaritur nga dita e publikimit.

Dokumentet parashtrohen:

- përmes postës ose në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr.9, 1000 Shkup;
- në mënyrë elektronike, në e-mail adresën: rpavlova@ukim.edu.mk.

Konferenca interuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut